

**SHOQËRIA TREGTARE
"SHTYPSHKRONJA MORAVA" SHPK
TIRANË**

**VENDIM NR. 03 datë 09. 07. 2005
I ORTAKUT TË VETËM
TË SHOQËRISË TREGTARE
"SHTYPSHKRONJA MORAVA" SHPK**

Në Tiranë, sot në datën 09 muaji Korrik, 2005, u mbledh Ortaku i Vetëm i Shoqërisë Tregtare "SHTYPSHKRONJA MORAVA" SHPK, në selinë e shoqërisë, për shqyrtimin e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Ekspertit Kontabël të Autorizuar për Vlerësimin e Rezervave dhe Fitimeve të Pashpërndara për Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë, të datës 08. 07. 2005 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabël i Autorizuar.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, z. AGRON MORAVA, pasi u njoh me rendin e ditës;

V Ë R E N S E

Shoqëria Tregtare "SHTYPSHKRONJA MORAVA" SHPK, është regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar me Vendimin Nr. 19916 datë 21.08.1998 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Ortak i Vetëm i kësaj shoqërie është z. AGRON MORAVA . Kapitali themeltar i nënshkruar i kësaj shoqërie është 61.065.000 (Gjashtedhjetenjemilione gjashtedhjetepesemije) Lekë. Kështu, z. AGRON MORAVA , zotëron 100 % të kapitalit themeltar të nënshkruar, i barabartë kymë 100 (njëqind) kuotave vlerën 61.065.000 (Gjashtedhjetenjemilione gjashtedhjetepesemije) Lekë, ku secila kuotë ka vlerën prej 610.650 (gjashtëqindhjetemijegjashtëqinpesedhjetepesemije) Lekë;

Me Vendimin Nr. 03 datë 27. 06. 2005, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka vendosur:

1. Zmadhimin e kapitalit themeltar të nënshkruar të shoqërisë me anë të Rezervave dhe Fitimeve të pashpërndara gjendje me 31 Dhjetor 2004;
2. Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabël i Autorizuar, me Nr. Liçence 97 datë 13 .12. 2000, për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit themeltar të nënshkruar me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të datës 31. 12. 2004;
3. Depozitimin e këtij vendimi pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë TIRANË.

Ky vendim është depozituar pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar me Vendimin Nr. 19916/3 datë 05.07. 2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Në vështrim të rendit të ditës, Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie, pasi njihet me Raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar për Vlerësimin e Rezervave dhe Fitimeve të Pashpërndara për Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë, të datës 08. 07. 2005, i përgatitur nga Eksperti Kontabël i Autorizuar z. Lavdimir FUSHA, vëren se ky raport është i drejtë, në përputhje me ligjet në fuqi dhe për këto arsye duhet miratuar. Ortaku i Vetëm, gjithashtu vëren se z. Lavdimir FUSHA , në detyrën e ngarkuar nga ana e saj, ka punuar me seriozitet, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe etikën e profesionit, gjë e cila vlen për t'u admiruar.

Sipas këtij raporti, zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet nga 61.065.000 (Gjashtedhjetenjemilione gjashtedhjetepesemije) Lekë në 71.300.000 (shtatëdhjetenjemilione treqindmije) Lekë, e barabartë kjo me 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali, secila me vlerë nominale prej 713.000 (shtatëqindetrembedhjetemije) Lekë. Pra,

SHOQËRIA TREGTARE
“SHTYPSHKRONJA MORAVA” SHPK
TIRANË

numri i kuotave (pjesëve) të kapitalit themeltar të nënshkruar mbetet i pandryshueshëm dhe vetëm vlera nominale e tyre rritet.

Ky kapital do të zotërohet nga Ortaku i Vetëm në këtë mënyrë:

Z. AGRON MORAVA, do të jetë përsëri zotërues e 100 % të kuotave të kapitalit themeltar, i cili do të përbëhet nga 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali nga ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 713.000 (shtateqindetrembedhjetemije) Lekë.
Për këto arsye, Ortaku i Vetëm, pas shqyrtimit të rendit të ditës;

V E N D O S I

1. Miratimin e Raportit të Ekspertit për Vlerësimin e Rezervave dhe Fitimeve të Pashpërndara për Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë të datës 08. 07. 2005, përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabël i Autorizuar;
2. Zmadhimi i Kapitalit Themeltar të nënshkruar të kësaj shoqërie nga 61.065.000 (Gjashtedhjetenjemilione gjashtedhjetepesemije) Lekë në 71.300.000 (shtatedhjetenjemilionetreqindmije) Lekë, e barabartë kjo me 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali;
3. Numri i kuotave (pjesëve) të kapitalit, mbetet i pandryshueshëm, dhe rritet vetëm vlera nominale e tyre;
4. Vlera e çdo kuote (pjesë) kapitali kalon nga 610.650 (gjashteqinddhjetemije gjashteqindpesedhjetë) Lekë në 713.000 (shtateqindetrembedhjetemije) Lekë;
5. **Z. AGRON MORAVA**, do të jetë përsëri zotëruese e 100 % të kuotave të kapitalit themeltar, i cili do të përbëhet nga 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali nga ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 713.000 (shtateqind etrembedhjetemije) Lekë;
6. Depozitimi i këtij vendimi pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë TIRANË

ORTAKU I VETËM
I SHOQËRISË TREGTARE
“SHTYPSHKRONJA MORAVA ” SHPK

Z. AGRON MORAVA

